



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 19

Prishtinë, më 10.07.2015, në orën 10:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, kryetare, Salihe Mustafa, Slavko Simiq Mexhide Mjaku-Topalli, Mytaher Haskuka, Teuta Haxhiu, Etem Arifi dhe Kujtim Paçaku.

Mungoi: Valdete Bajrami.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Reshit Gashi, koordinator i Komisionit, Sulltane Gashi, zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit, UNICEF.

Të ftuar: Hilmi Jashari- Avokat i Popullit, Isa Hasani- Zëvendësavokat i Popullit dhe Bogoljub Staletović- Zëvendësavokat i Popullit.

Pjesëmarrës të tjerë: Selvete Gerxhaliu-GDJND; Kaltrina Ahmeti-GLPS; Tringa Bytyçi-GLPS, Ukë Gashi-ZPRK; Lejla Imeri-YIHR; Majlinde Sinani Lulaj –IAP, Lejla Selimi-OSBE, Sakibe Jashari-Ambasada Zvicerane dhe Arta Xhylani, praktikante në Kuvendin e Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve nr. 16 dhe nr. 17;
3. Shqyrtimi i peticioneve;
4. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me propozimin e kryetares, që nga rendi i ditës të hiqet pika 4, që ka të bëjë me raportin e monitorimit të Ligjit për personat e verbër.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve nr. 16 dhe nr. 18

Kryetarja konstatoi se Komisioni i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 22.05.2015 dhe 03.06.2015.

3. Shqyrtimi i peticionit

Kryetarja i njoftoi anëtarët e Komisionit që në rend ditë është shqyrtimi i peticionit të paraqitur nga Z. Staletoviq në cilësinë e zëvendësit të Avokatit të Popullit. Ajo fillimisht i uroj mirëseardhje Avokati të Popullit z. Hilmi Jashari, i cili është zgjedhur Avokat i Popullit.

Hilmi Jashari – Pasi i përshëndeti anëtarët e Komisionit, i informoi ata se ditën e hënë, më 6 korrik, e ka marrë pozitën e Avokatit të Popullit dhe lidhur me çështjen e z. Staletoviq tha se do të japë përgjigje zëvendësi i Avokatit të Popullit, Z. Isa Hasani.

Isa Hasani – Lidhur me çështjen e z. Staletoviq, i informoi anëtarët e Komisionit se baza ligjore në të cilën e mbështet veprimtarinë Institucioni i Avokatit të Popullit janë Ligji për Avokatin e Popullit, Rregullorja e Punës së Avokatit të Popullit, si dhe Kodi i Etikës në këtë institucion. Në bazë të këtyre dokumenteve janë përcaktuar edhe kompetencat e personelit në këtë institucion. Po ashtu ai tha se i kanë dy komisione brenda Institucionit, Komisioni kolegjal dhe Komisioni disiplinor. Lidhur me rastin konkret ai tha se Avokati paraprak në bazë të kompetencave ligjore ka bërë propozim për shkarkimin e z. Staletoviq nga pozita e zëvendësit të Avokatit të Popullit, mirëpo për shkak të vakumit institucional në Kosovë shqyrtimi i atij propozimi nga ana e Kuvendit është vonuar. Ai e theksoi se veprimet e z. Staletoviq kanë qenë në kundërshtim me dokumentet e lartcekura, e ka shtyrë Avokatin e Popullit që Kuvendit t’ia paraqesë propozimin për shkarkim të z. Staletovic. Ai theksoi se ka pasur problem edhe në komunikim lidhur me këtë çështje, dhe edhe kjo ka ndikuar që të vështirësohet situata, sepse z. Staletoviq ka kërkuar përkthimin e disa dokumenteve të cilat Institucioni i Avokatit të Popullit e ka pasur të pamundur t’i përkthejë më stafin që e ka aktualisht.

Kryetarja – I informoi të pranishmit se janë të detyruar që të shkojnë në Seancë Plenare pasi që ka mungesë kuorumi dhe nuk ka mundësi që të vazhdohet mbledhja e Komisionit.

Salihe Mustafa – Duke u ndërlidhur me këtë çështje pyeti z. Hasanin se si e kanë ndjerë vetën kur e kanë ditur se Avokati i Popullit e ka privilegjuar z. Staletoviq në dhënien e veturës, kur dihet se Avokati i Popullit e ka për detyrë që t’i mbrojë të drejtat e njeriut.

Pas këtij diskutimi takimi u ndërpre për shkak të obligimit të anëtarëve të Komisionit për të marrë pjesë në Seancën Plenare në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 10:50.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Lirije Kajtazi